



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:263265

Datë: 25.10.2022

Numri i dokumentit: 03569010

A.nr.128/19

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtarin Kreshnik Kaçiu dhe zyrtaren ligjore Shqipe Jashari, në konfliktin administrativ të paditësit A. Sh. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xh. Sh., avokat nga P., kundër të paditurit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, për shkak të anulimit të vendimit Nr.294/18 të datës 20.11.2018, pas shqyrtimit kryesor publik, me datën 18.10.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit A. Sh. nga P., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xh. Sh., avokat nga P., me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi Nr.294/18 i datës 20.11.2018 i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike u mbajt në kuptim të nenit 41 të LKA-së, me praninë e të dy palëve ndërgjyqëse.

Paditësi me padinë e datës 16.01.2019 dhe më pas me plotësimin e padisë të datës 16.09.2021, ka kërkuar nga Gjykata që të aprovohet si e bazuar padia e paditësit e ushtruar kundër vendimit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit. Në padinë e tij, paditësi pohon se ankesa e tij është refuzuar në mënyrë të kundërligjshme, se i padituri nuk i ka aplikuar fare ose nuk i ka aplikuar drejt dispozitat ligjore dhe për shkak se në procedurë që i ka paraprirë aktit, nuk është vepruar sipas rregullave të procedurës, nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike. Shton se ankesa nuk është marrë në konsideratë siç shihet nga vendimi i atakuar nuk është analizuar asnjë pretendim i ankuesit, është injoruar plotësim dhe pa shqyrtim të asnjë pretendimi “përmendësh”, sa për të

kaluar radhën është nxjerrë vendimi i atakuar. I propozon Gjykatës që të nxjerr Aktgjykim me të cilin aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe të anulohet vendimi i atakuar me padi.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesi i paditësit deklaroi: *“Mbetem në tërësi si në padi për shkak se kërkesa e ARRU-së, dhe Kompanisë së Ujësjetës Rajonal Prishtinë janë të jashtëafatshme në bazë të nenit 360 të LMD-së. Pala e paditur për kohën prej vitit 2008 nuk ka dorëzuar faturat për shpenzimet e ujit tek paditësi dhe meqenëse nuk ka kërkuar shërbim të cilat i janë ofruar brenda afatit të caktuar ligjorë , e konsideroj se janë kërkesa të përshkruara . Paditësi atë banesë nuk e ka shfrytëzuar për kohë të gjatë dhe për gjithë kohën sa ka qëndruar në banesë pa faturë dhe në kërkesë të inkasantit e ka kryer pagesën . Paditësi banesën e tij e shiti në vitin 2017 dhe prej muajit nëntor të vitit 2017, e mori në dijeni kërkesën e kompanisë rajonale për ujë Prishtina. Konsideroj se vendimi i cili është i nxjerrë prej kompanisë ku kërkesa për shlyerje të borxheve si të përshkruara i është refuzuar , edhe pse gjatë asaj periudhe kemi marrë informata se ka pasur më shumë se dy herë falje të borgjeve të vjetra , ndërsa nuk ka qenë paditësi i njoftuar për falje të borxheve të cilat janë bërë nga ana KRU-Prishtina. Konsideroj se vendimi është i pa bazuar dhe duhet të hidhet poshtë. Në lidhje me çështjen e parashkrimit kur nxirret vendimi nga këshilli i konsumatorëve dhe e kthen në rishqyrtim rastin me dt. 26.06.2018, duke nxjerr vendimin numër 149/18 në arsyetimin e tijë thuhet se ka kontestuar borxhin për shkakë se faturat janë dorëzuar në adresën e gabuar pra nuk janë dorëzuar fare. Ndërkaq në pyetjen e gjyqtarit për përfaqësuesin e paditësit nëse i njëjti që para kësaj gjykate të provoj se i njëjti tek e paditura e ka ngritur pretendimin ankimor që ka të bëjë me çështjen e përshkrimit të borxhit, i autorizuari i paditësit përgjigjet: Unë jam avokat i një pale të pa zënë e cila nuk ka informacione për dispozitat ligjore dhe kërkesat e prera të paraqitura me pyetjen tuaj . Brenda një afit të arsyeshem do ti kërkoj ankesat e paraqitura nga ana e paditësit dhe konsideroj se ka qenë detyrë e ndërmarrjes Publike që të veproi në bazë dispozitave ligjore me kërkesat për realizimin e pretendimeve të tyre. Vendimin të cilin e ka nxjerr organi i shkallës së parë dhe i padituri asnjëri nuk kanë vlerë monetare me kusht që me u dit detyrimi i paditësit ndaj tyre , gfarëdo pretendimi që bëhet nga pala e paditur është kërkesë e re të cilën unë e konsideroj të përshkruar në bazë të dispozitës së referuar më herët sipas LMD-së .*

Ndërkaq në fjalën përfundimtare deklaroi: *“Konsideroj se paditësi është i ngarkuar kundërligjshëm me pretendime të paraqitura nga ana e të paditurës dhe në mënyrë të kundërligjshme kërkohet që të jetë përgjegjës për borxhet të cilat janë të parashkruara gjë që shihet edhe nga kartela e KRU-Prishtina prej vitit 2013 deri në vitin 2017, e kur fillohet me një borxh i cili është i pa arsyetuar. Kërkoj nga gjykata ta hedh poshtë si të pa bazuar vendimin e ARR-së, nr. 411/2 dt. 30.11.2018, me numër të brendshëm Nr.294/18 i dt. 20.11.2018. Gjykatës i propozoi të aprovohet kërkesëpadia e paditësit , të anulohet vendimi i të paditurit ARRU si dhe të gjitha vendimet tjera nga të cilat ka rrjedh zgjedhja e këtij vendimi duke e liruar nga të gjitha detyrimet e pretenduara nga e paditura”.*

E paditura me përgjigjen në padi të datës 22.11.2021 e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar ka deklaruar se padia e paditësit është plotësisht e pabazuar dhe e pambështetshme në gjendjen faktike, ngase normativa në lidhje me çështjet e shpenzimeve të ujit është e rregulluar në atë mënyrë që kursesi nuk e liron nga përgjegjësia

konsumatorin për ndarjen e konsumit në mënyrë të barabartë në banesën/objektin kolektiv në mes të banorëve të cilët nuk i kanë të instaluar ujëmatësit individual. Shton se paditësi ka qenë i obliguar që si pronar legjitim i banesës t'i përditësoj të dhënat te ofruesi i shërbimeve të ujit, gjë që një veprim të tillë nuk e ka bërë asnjëherë deri me paraqitjen e ankesës. Poashtu shton se parashkrimi i borxhit nuk ka qenë pretendim ankimor i parashtruar nga paditësi në asnjërin nga ankesat e parashtruara në procedurën administrative.

Në seancën e shqyrtimit kryesor, përfaqësuesja e të paditurës deklaroi: *“Mbetem në tërësi pranë përgjigjes në padi, theksoj se kërkesëpadia e paditësit për anulim të vendimit kontestues është e pa bazuar dhe e pa mbështetur në gjendje faktike sepse fillimisht paditësi banesën e ka blerë në vitin 2021, paditësi ka qenë i obliguar në pajtim me rregulloren në fuqi me nenin 8 të rregullores për kartën e konsumatorit për ofruesit e shërbimit të ujit vitit 2010, ka qenë i obliguar të lidh kontratë me ofruesin e shërbimit pra edhe neni i vjetër i rregullores parasheh se konsumatori është i obliguar të bashkëpunoj me ofruesin e shërbimeve ti ofroj të dhënat e tija personale lidhur me banesën në fjalë, këtë paditësi nuk e ka përmbush këtë obligim në asnjë formë. Këtë çështje e parasheh edhe rregullorja 03/2016 për Kartën konsumatorit të shërbimeve të ujit në Kosovë në neni 1 paragrafi 1,1 të kësaj rregullore. Paditësi ka qenë i obliguar të vendosë ujëmatësin individual , pra rregullorja për standarde minimale të shërbimeve të ofruesve të shërbimit të ujit në Kosovë 03/2011 me nenin 37 paragrafi 1 parasheh që të gjithë konsumatorët të cilët aktualisht nuk kanë ujëmatës janë të obliguar që në ndërtesat e banimit kolektiv që brenda 1 viti të hyrjes në fuqi të kësaj rregullore të vendosin ujëmatësin individual. Meqenëse paditësi nuk ka vendosur matësin individual , atëherë është faturuar në bazë të ujëmatësit kolektiv dhe në pajtim me nenin 38 pika b të rregullores EF03/2011, në pajtim me nen 07 të rregullore 02/2016 për standarde minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë, gjegjësisht paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 pika 122. Në lidhje me parashkrimin theksoj se kjo kërkesë nuk është ngritur as në shkallën e parë e as me ankesë në shkallën e dytë , se në pikëpamjen tonë kjo është kërkesë e re dhe kjo nuk mund të trajtohet në procedurë administrative por në procedurë Kontestimore. Lidhur me pretendimin se paditësi nuk ka pranuar faturat konsideroj se faturat janë dërguar meqenëse faturimi bazohet në kod dhe kodi është i njëjtë për at banesë , pra fajtor është paditësi që nuk i ka përditësuar të dhënat në kompani . Lidhur me pretendimin e paditësit se nuk e ka shfrytëzuar banesë dhe është faturuar, ne konsiderojmë se deri sa paditësi nuk e ka pasur të instaluar ujëmatësin individual nuk ka mundësuar mundësi që ai të trajtohet si konsumator pasiv, ngase ujëmatësi individual është instrumenti i vetëm që përcakton saktë hargjimin e ujit. Sa i përket pretendimit lidhur me faljen e borxheve publike duhet theksuar se ky pretendim nuk mund të pranohet si i tillë ngase paditësi ka qenë i obliguar në pajtim me nenin 4 të ligjit për falje publike fillimisht të bëjë kërkesë pran ofruesit të shërbimeve dhe të lidh marrëveshje për pagesën e borxheve pas janarit të vitit 2009 deri 2014”.*

Më tutje, në fjalën përfundimtare, deklaroi: *“Konsideroj se janë dhënë argumente, prova të mjaftueshme dhe gjykatës i propozojmë që pas administrimit të provave të merr aktgjykim me të cilin do të refuzohet kërkesëpadia e paditësit dhe vendimi i të paditurës nr. 294/19 të mbetet në fuqi”.*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: vendimi 149/18 i dt. 26.06.2018, vendimi i KRU-Prishtina, i dt. 11.04.2018, kartela financiare e konsumatorit për periudhën kohore prej 01.01.2013 deri me 05.12.2017, fatura e tatimit në pronë e dt. 15.11.2017, transaksionet e konsumatorit për ofruesin e shërbimeve KESCO nga data 01.01.2015 deri me 31.12.2017, vendimi numër 294/18 i dt. 20.11.2018, vendimi i KRU-Prishtina, i dt. 12.09.2018, procesverbali për kontroll dhe inspektim me numër 01/11 dt. 11.04.2018 dhe procesverbali i dt. 27.07.2018, formulari i ankesës dt. 05.04.2018 dhe 11.05.2018, ankesa pa numër dhe pa datë, kontrata për shitblerje e dt. 05.02.2001, aktvendimi i drejtoratit për financa dhe pronësi i K.K. Prishtinë dt. 26.07.2002, kontrata kryesore për shitblerje të paluajtshme risë me numër reference 1167/2017 e dt. 31.10.2017, ekstrakti nga librat e kontabilitetit me datë të printimit 16.11.2021, kartela financiare konsumatorit për periudhën 01.01.2013 deri me dt. 25.06.2018, përgjigje e dt. 16.11.2021, procesverbali për shqyrtim të ankesë dt. 12.09.2018 dhe 12.04.2018, shkresa me titull shpërndarja e shpenzimit të matësit me kod 26351 për vitin 2020, 2019 dhe 2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

Gjykata gjeti se Vendimi i kontestuar nga ana e të paditësit është marrë konform të gjitha dispozitave procedurale dhe ligjore në fuqi dhe se i njëjti në asnjë rrethanë nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave procedurale, as vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e as zbatim të gabueshëm të së drejtës materiale. Vendimi i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit konform nenit 47 të LPPA-së.

Gjykata hodhi poshtë pretendimet e paditësit në lidhje me atë nëse borxhi i akumuluar për pagesën e ujit është parashkruar apo jo, për faktin që paditësi nuk ka dëshmuar që të njëjtat pretendime ti ketë ngritur në procedurë të rregullt administrative e që më pastaj për të njëjtat të ngris pretendime edhe në Gjykatë.

Gjykata poashtu refuzoi pretendimet e paditësit që ndërlidhen me çështjen e faljes së borxhit të ujit konform Ligjit Nr.05/L-043 si dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.04/04/2015, për faktin që ka qenë në përgjegjësinë e secilit konsumator i cili ka pasur borxhe ndaj kompanive të ndryshme për furnizimi me ujë, që vet të inicojnë procedurën administrative për arritjen e marrëveshjeve për faljen e borxheve dhe në këtë rast, nuk mund të mbahet përgjegjës as i padituri dhe as Kompania përkatëse e Ujësjetës, për mos veprimin e paditësit sa i përket kësaj çështjeje.

Gjykata erdhi në përfundim se vendimi i kontestuar i të paditurës në mënyrë të qartë ka përshkruar dhe vlerësuar veçanërisht aspektin formal e procedural që është zhvilluar përgjatë gjithë trajtimit të çështjes administrative të paditësit.

Andaj, duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e sipërcituara, gjykata vlerëson se vendimi i goditur me padi është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar juridike.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të paditësit, por të njejtat i vlerësoi si të pa bazuara, ngase të njejtat nuk i ka provuar me asnjë provë të vetme, as para të paditurës e as me padinë e ushtruar në këtë Gjykatë.

Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, e paditura drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material, kur ka marrë vendimin e kontestuar nga paditësi. Mbi këto arsye thëniet e paditësit në padi nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër juridike, nga ajo e vërtetuar nga e paditura.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46, paragrafit 2, lidhur me nenin 5, 6 dhe 38 të LKA-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË  
Departamenti për Çështje Administrative  
A.nr. 128/19, datë: 18.10.2022

G j y q t a r i

---

Kreshnik Kaçiu

Këshillë Juridike: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.